РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr_______

________г./v.

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e73-të, të mbajtur më 18.08.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-4518/1, datë 05.11.2021, kundër personit ------------, udhëheqës në -------------, IHIDHET POSHTË.

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës, dhe e njëjta të dorëzohet në institucionet kompetente.

Lënda me numër 12-4518 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 05.11.2021është dorëzuar denoncim për personin---------------udhëheqës në ---------------dhe është formuar lënda me numër 12-4518 i vitit 2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se kërkon nga KSHPK-ja të kontrollojë nëse personi i treguar është e vetëpunësuar si kontabiliste në kompaninë e saj, në mënyrë që ajo të dorëzojë dhe nënshkruajë deklaratën tatimore të kompanisë.

Në denoncim thuhet gjithashtu se parashtruesi, përveç denoncimit në KSHPK, do t'i drejtohet Drejtorisë së të Ardhurave Publike, inspektoratit përkatës, si dhe Odës së Kontabilistëve.

Pas shqyrtimit të pretendimeve , KSHPK-ja konstaton se në rastin [02] [03] bëhet fjalë për pretendime që nuk i nënshtrohen veprimit të saj kompetent, por janë pretendime që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, ku parashtruesi ka përmendur që do t'i drejtohet, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. K.Z.

Miratoi: Mr. SH.S anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetare,
Biljana Ivanovska